

BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE
PROCES VERBAL & VENDIME
qarkulluese, 29 Maj 2026



Në mbledhje morën pjesë këta pjesëmarrës:

<u>Emri i pjesëmarrësve</u>	<u>Përqindja</u>
1. Z. Kadri Morinaj, përfaqësues i EUROSIG SH.A	91.57%
2. Z. Kadri Morinaj, përfaqësues i DTU Eurosig Investment Doool Shkup	7.83%
3. Z. Kadri Morinaj, përfaqësues i EURO-ALBA-EA Sh.p.k.	0.02%
4. Z. Kadri Morinaj	0.02%
	Total:
	99.44%
5. <u>Pjesëmarrës të tjerë:</u> Znj. Bora Feri, Drejtor i Përgjithshëm i BBSH Z. Jemin Gjana, Kryetar i Këshillit Drejtues	

Sekretare e Mbledhjes:

Znj. Enxhi Karalliu, Drejtor Dep. i Përputhshmërisë

Pjesëmarrja në mbledhje nga aksionerët dhe përfaqësuesit e tyre u bë online (qarkulluese) dhe përfaqësoi 99.44% të totalit të kapitalit të paguar të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë. Identifikimi i aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre është siguruar dhe garantuar në përputhje me ligjin.

Mbledhja u thirr për të diskutuar si në vijim:

RENDI I DITËS:

- I. *Miratimi i ndryshimit të pjesëmarrjes influencuese të tërthortë të aksionarit Kadri Morinaj;*
- II. *Rivlerësimi i Administratorëve të Bankës për vitin 2025.*
- III. *Azhornim i të dhënave të aksionarëve;*
- IV. *Çështje të tjera:*
 - *Zmadhimi i kapitalit në BBSH*

Z. Kadri Morinaj u emërua nga Asambleja si Kryetar për të drejtuar mbledhjen, ndërsa znj. Enxhi Karalliu u emërua Sekretare për regjistrimin e procedurës, në bazë të nenit 29 dhe 32 të Statutit të bankës.

Mbledhja filloi me ekzaminimin mbi kuorumin e nevojshëm për pjesëmarrje në mbledhje: u vëzhguua që pjesëmarrja në mbledhje përfaqësonte 99.44% të kapitalit të bankës, për këtë arsye kuorumi është i

BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE
PROCES VERBAL & VENDIME
qarkulluese, 29 Maj 2026



mjaftueshëm. U vërejt se mbledhja ishte thirrur rregullisht nëpërmjet njoftimeve të dërguar nga banka tek të gjithë aksionarët më datë 08.05.2026 së bashku me rendin e ditës. Kështu që mbledhja filloi me rendin e ditës së njoftuar dhe pjesëmarrësit nuk kishin asnjë vërejtje ose kundërshtim mbi të.

Çështjet e rendit të ditës dhe dokumentet përkatës u shqyrtuan një e nga një nga aksionarët dhe vendimet e marra nga pjesëmarrësit janë bashkëlidhur këtu.

AKSIONARËT

EUROSIG SH.A
Përfaqësuar nga Kadri Morinaj

DTU Eurosig Investment Doel Shkup
Përfaqësuar nga Kadri Morinaj

EURO-ALBA-EA Sh.p.k.
Përfaqësuar nga Kadri Morinaj

Kadri Morinaj



Sekretare: Enxhi Karalliu

VENDIM NR. 4

Çështje të tjera: Zmadhimi i kapitalit në BBSH

Duke qenë se realizimi i procesit të zmadhimit të kapitalit që do të kryhet nga EURO-ALBA-EA-Deutschland GmbH i cili tashmë ka nisur, paraqet vonesa si pasojë e shkaqeve administrative burokrarike, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve shqyrtoi mundësinë e kryerjes së një procesi tjetër për zmadhimin e kapitali nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja, me qëllim plotësimin e kërkesave rregullatore nga Banka e Shqipërisë.

Kështu, u propozua që numri i aksioneve të reja të emetuara të jetë 64,022 aksione, në vlerën totale 109,999,346.32 Lekë.

Për sa më lart, menaxhimi i bankës përgatiti procedurën për rritjen e kapitalit me mjete likuide, nëpërmjet lëshimit të aksioneve të reja që do t'u ofrohen fillimisht të gjithë aksionarëve bazuar në të drejtën e tyre të parablerjes dhe më pas palëve të tjera të interesuara, sipas Statutit të bankës dhe dispozitave të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Procedura bazohet gjithashtu në Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, Ligjin Nr. 9662 datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe Rregulloren e Bankës së Shqipërisë Nr. 14, datë 11.03.2009 "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe dispozita të tjera ligjore të zbatueshme.

Për gjithë sa më lart, pasi e diskutoi çështjen në tërësi, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me shumicë votash që përfaqësojnë 99.44% të kapitalit aksionar:

VENDOSI

1. Të miratojë zmadhimin e kapitalit nëpërmjet fondeve likuide në shumën **109,999,346.32 Lekë/-** (njëqind e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet e gjashtë pikë tridhjetë e dy Lekë), duke emtuar 64,022 aksione të reja me vlerë nominale 1,718.15 Lekë/- (një mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë pikë pesëmbëdhjetë) për aksioner. Shuma e zmadhimit të kapitalit e shpërndarë proporcionalisht për të gjithë aksionerët është bashkëngjitur si Aneksi 1.
2. Aksionet e reja do të nënshkruhen kundrejt kontributeve të reja dhe aksionerët e BBSH-së mund të ushtrojnë të drejtën e tyre preferenciale për nënshkrimin e aksioneve të reja, përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e tyre në kapital. Në përputhje me Nenin 174 të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe Statutit të Bankës, aksionerët kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për aksionet e reja të emetuara në bazë proporcionale. E drejta e parablerjes do të ushtrohet në dy faza: (i) në fazën e parë, aksionet e reja do tu ofrohen aksionarëve ekzistues në bazë proporcionale. Aksionerët duhet të shprehin interesin e tyre (ushtrimi i të drejtës së parablerjes) brenda 20 ditëve nga dita e publikimit të këtij vendimi për miratimin e zmadhimit të kapitalit. (ii) pas mbylljes së fazës së parë, në rast se jo të gjithë aksionerët kanë ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes në bazë proporcionale, numri i mbetur i aksioneve do t'u ri-ofrohet aksionarëve ekzistues të cilët e kanë ushtruar të drejtën e parablerjes gjatë fazës së parë dhe një afat shtesë prej 2 ditësh do t'u jepet këtyre aksionarëve për të ushtruar të drejtën e parablerjes në fazën e dytë. Nëse pas mbylljes së fazës së dytë,

BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE
PROCES VERBAL & VENDIME
qarkulluese, 29 Maj 2026



- këta aksionare nuk e kanë ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes, aksionet e reja do t'u ofrohen palëve të treta si investitorë të mundshëm.
3. Të miratojë pagesën e aksioneve të reja të nënshkruara nëpërmjet pagesës në llogarinë e caktuar bankare, siç do të përcaktohet nga një përfaqësues i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.
 4. Secilit prej aksionarëve do t'i dërgohet Njoftimi "Ftesë për blerjen e aksioneve" së bashku me Njoftimin 2 "Pranim" dhe Njoftimin 3 "Mospranim".
 5. Ky vendim i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme do të publikohet në faqen zyrtare të Bankës: www.uba.com.al dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB): www.qkb.gov.al, në përputhje me Nenin 169 të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
 6. Ky vendim i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme do të depozitohet dhe në Bankën e Shqipërisë, në përputhje me Ligjin Nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
 7. Shuma për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet blerjes së aksionet e reja duhet të paguhet në llogarinë e ndërmjetme për zmadhim kapitali të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.
 8. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm të Bankës për të ndjekur këtë proces, të regjistrojë këtë vendim dhe dokumentet e tjerë në lidhje me të pranë autoriteteve përkatëse për respektimin e procedurave të kërkuara.
 9. Pasi pagesa e aksioneve të reja të jetë kryer, një vendim tjetër do të merret nga Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Aksionarëve për finalizimin e procesit dhe do të miratohen ndryshimet përkatëse në strukturën e kapitalit. Për këtë arsye, kjo mbledhje mbetet e hapur.

EUROSIG SH.A
Përfaqësuar nga Kadri Morinaj

EURO-ALBA-EA Sh.p.k.
Përfaqësuar nga Kadri Morinaj

AKSIONARËT

DTU Eurosig Investment Doel Shkup
Përfaqësuar nga Kadri Morinaj

Kadri Morinaj

Sekretare: Enxhi Karalliu

Banka e Bashkuar e Shqipërisë



Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve

BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE
PROCES VERBAL & VENDIME
qarkulluese, 29 Maj 2026



ANEKSI 1

Shuma e zmadhimit të kapitalit e shpërndarë proporcionalisht për të gjithë aksionarët

Aksionerët Ekzistues	Vlera Nominale për Aksion (Lekë)	Përqindja për Aksionar	Nr. i aksioneve të reja ofruar secilit aksionar brenda të drejtës së parablerjes	Vlera nominale e aksioneve të reja për cdo aksionar ekzistues (Lekë)
Eurosig sh.a.	1,718.15	91.57%	58,625	100,726,495.23
Kadri Morinaj	1,718.15	0.02%	13	22,335.94
Euro-Alba-EA sh.p.k	1,718.15	0.02%	13	22,335.94
Saudi Brothers Commercial Co.	1,718.15	0.12%	77	132,297.49
Hamed H. Mutabagani	1,718.15	0.36%	230	395,174.31
Hayder Mohamad Awad	1,718.15	0.05%	32	54,980.77
Faisal A. El Khereiji	1,718.15	0.03%	19	32,644.83
DTU Eurosig Investment Shpk Shkup	1,718.15	7.83%	5,013	8,613,081.80
Total		100.00%	64,022	109,999,346.32

EUROSIG SH.A

Përfaqësuar nga Kadri Morinaj

EURO-ALBA-EA Sh.p.k.

Përfaqësuar nga Kadri Morinaj

Sekretare: Enxhi Karallu

AKSIONARËT

DTU Eurosig Investment Dooel Shkup
Përfaqësuar nga Kadri Morinaj

Kadri Morinaj

